



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0362

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Isa Hasani Anetar dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së OE “BLACK TREE” L.L.C., kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-25-2740-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KK PRISHTINË”, më 21/08/2025, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “BLACK TREE” L.L.C. me nr. 2025/0362, e datës 13/05/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës”, me numër të prokurimit 616-25-2740-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KK PRISHTINË”. **AK lejohet te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.**

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 03/04/2025 “KK PRISHTINË” ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-25-2740-2-1-1,

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 800,000.00€.

Me 06.05.2025, OE “BLACK TREE” L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 13.05.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13/05/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga “BLACK TREE” L.L.C., me nr. 2025/0362, lidhur me aktivitetin “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-25-2740-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuuese si në vijim:

Kërkesë për standardet ISO dhe EN 16636:2015: Kërkesa për të pasur certifikatat ISO 9001:2015 dhe ISO 55001 : 2018 si dhe standardin EN 16636:2015 është vendosur në përputhje me nenin 70 të LPP-së dhe Rregullores 001/2022 me të cilat lejohet të përcaktohen standarde të njohura ndërkombëtare për të garantuar cilësi dhe siguri në ofrimin e shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në Shëndetin Publik.

Standardi EN16636 është standard specifik për shërbimet e kontrollit të dëmtuesve (DDD) dhe është në përputhje me praktikat më të mira evropiane, ndaj kërkesa për të nuk paraqet shkelje të ligjitpor përkundraizpërmison cilësinë e shërbimeve të kërkuara.

Pretendimi i OE-së se kjo kërkesë është diskriminuese nuk qëndron, pasi standardi është publik dhe i qashtë për çdo operator. Prandaj, kjo kërkesë refuzohet si e pabazuar në përputhje me nenin 28 dhe 70 të LP-së.

Kërkesa për stafin profesional: Kërkesa për të paktën 16 punëtorë dhe një epidemiolog me përvojë 3 vjeçare është vendosur në përputhje me natyrën e projektit. Projektipërfshin trajtimin e 6,850 hektarëve brenda një kohe të kufizuar dhe kërkon intervenim të organizuar dhe të mbikëqyrur nga staf me përgaditje adekuate.

Kemi paraparë që stafi profesional përmes ndjekjes së moduleve apo trajnimeve që përmbajnë përmbajtje teknike të IPM-së. Prandaj, kërkesa për “ punëtorë të certifikuar për IPM” nuk është vendosur si certifikatë zyrtare e akredituar nga ndonjë organ publik, por si dëshmi trajnimeve ose përgaditjeje në metodologjinë IPM nga institucione/organizata që ofrojnë edukim profesional, si pjesë e rritjes së cilësisë së shërbimit. Kjo nuk kufizon konkurrencën dhe është në përputhje me nenin 6,7 dhe 69 të LPP-së.

Paisjet dhe mekanizmi teknik i kërkuar -Lista e paisjeve është hartuar në përputhje me nevojat reale për realizimin e projektit në mënyrë profesionale dhe efikase. Sipas përlllogaritjeve teknike të sipërfaqes dhe

kohës së intervenimit, është përcaktuar saktë numri i paisjeve ULV Generator, pompa LV, automjete për bartje dhe vendosje të paisjeve. OE në ankesë ofron një përlllogaritje që bazohet në supozime teorike (duke bërë llogaritje në kushte ideale në sipërfaqe apo ambiente të pa banuara si p.sh. arajusha bujqësore por jo sipërfaqet urbane që kanë komplicitet struktural) pa marr parasysh vështirësit logjistike, kushtet klimatike dhe nevojën për intervenime të sinkronizuara në zonat urbane, vështirësive në qarkullimin urban dhe ndër urban, duke pasur parasysh konfigurimin e qytetit me shume rrugica të ngushta, pengesave infrastrukture, trafikut etj. Pengesave nga qytetarët dhe kushteve klimatike që kërkojnë angazhim shtesë dhe racioalizim kohorë pasi që ky proces realizohet në orët e muzgut (20:00 23:30) dhe me kohëzgjatje prej 4-5 ditëve nevojitet që gjatë këtij intervali kohorë të realizohet në përpikmëri fazat e dezinfektimit hapësinor.

Grupi punues konsideron se çdo operator ekonomik i interesuar për këtë aktivitetprokurimi duhet të ketë njohuri të mjaftueshme profesionale rreth natyrës së shërbimeve të kërkuara, përfshirë faktin se dezinfektimi hapësinor në territorin e Komunës së Prishtinës realizohet në orët e muzgut (mbrëmjes), kur aktiviteti i insekteve është më i lartë dhe efikasiteti i trajtimit është më i madh, dhe kjo kërkon paisje të mjaftueshme dhe domosdoshmepër arritjen e qëllimit të projektit. Kjo praktikë është aplikuar edhe në vitet e kaluara dhe është e dokumentuar në realizimin e projekteve të mëparshme të ngjajshme, të cilat janë të qasshme për çdo operator që ka interes të vërtetë profesional dhe përvojë relevante në këtë fushë. Grupi punues gjatë hartimit të specifikave të tenderit, është bazuar në përvojat praktike të mëparshme dhe në nevojën për një organizim logjistik që garanton realizim efikas dhe të pandërprerë të projektit në gjithë territorin e Komunës së Prishtinës. Në projektet DDD, sidomos kur bëhet fjalë për dezinfektimin hapësinor të jashtëm kërkohet koordinim në kohë reale dhe bartje e sciktë dhe e sigurt e paisjeve të specializuara , si Gjeneratorët ULV dhe Power Sprayer, të cilat janë paisje specifike që kërkojnë vendosje të qëndrueshme në automjete pune. Po ashtu, duhet të sigurohet transport i sigurt dhe i planifikuar i punëtorëve në lokacione të ndryshme, që shpesh janë të shpërndara në zona periferike, zona të gjelbërta, kolektorë dhe ambiente të ndjeshme urbane. Kërkesa për të pasur mjete të caktuara nuk është bërë për të përjashtuar operatorët ekonomikë,por për të siguruar kapacitetin funksional logjistik dhe teknik për realizimin e shërbimit në mënyrë profesionale. Mënyra e propozuar nga operatori ekonomik ankues, ku thuhet se punëtorët mund të transportohen me taxi, autobus apo mjete tëpapërcaktuara dhe pa asnjë organizim teknikparaprak, tregon qartë mungesë serioziteti dhe profesionalizmi, dhe sugjeron që OE në fialë nuk është realisht i interesuar për të ofruar shërbimin, por synon vetëm ta pengojë zhvillimin e një procesi të rregullt të prokurimit nga operatorë profesionalë. Kjo mënyrë e të menduarit dhe e pretenduar është në kundërshtim me nenin 6 ë LPP-së, i cili garanton economicitet dhe efikasitet në realizimin e kontratës, dhe me nenin 59, i cili i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues të kërkojë kapacitete teknike dheprofesionale nëpërputhje me natyrën e kontratës. Paisja Power Spayer është kërkuar në sasi minimale dhe për trajtime të caktuara ku është e nevojshme depërtimi i zgjalur në vegjetacion ose zona të dendura, deponive të mbeturinave, kontejnerëve, kolektorëve me ujëra të ndenjura dhe vendet me vegjetacion të dendur e gjithashtu duke u bazuar në përvojat e viteve të kaluara kjo metodë është tejet e domosdoshme /efikase dheprofesionale dhe se sipas raporteve tona në të kaluarën kapasur efikasitet të lartë për realizimin e këtij projekti. Grupi punues gjatë përpilimit të kërkesave dhe specifikimeve teknike në këtë aktivitet tëprokurimit, është bazuar nëpërvojatpraktike tëprojekteve të mëparshme si dhe në analizën e gjendjes reale dhe specifikave të territorit të Kryeqytetit.

Kërkesat e paraqitura nga operatori ekonomik në këtë kërkesë për rishqyrtim nuk janë të bazuara në parime profesionale dhe, nëse do merreshin për bazë, do të rrezikonin seriozisht efikasitetin, cilësinë dhe realizimin me sukses të projektit. Nuk përjashtohet përdorimi i paisjeve të tjera plotësuese, por Autoriteti

Kontraktues ka të drejtë të kërkojë specifikime teknike në përputhje me objektivat e kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me nenin 28 dhe 27 të LPP-së. KONKLuzion Pas analizës së plotë të pretendimeve dhe shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, grupi punues vlerëson se: Nuk janë shkelur dispozitat e LPP-së dhe Rregullorës për Prokurim Publik. Nuk ka elementë të diskriminimit, përjashtimit apo kufizimit të panevojshëm të konkurrencës. Kërkesat teknike janë vendosur në përputhje me nenet 6,7,27,28,65,69 dhe 70 të LPP. Prandaj grupipunues vlerëson se kërkesa e OEBLACK TREE L.L.C nuk është bazuar”. Nga sa u tha më sipër duke marrë parasysh sqarimet e ofruara nga njësia kërkuuese është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BLACK TREE” L.L.C., janë parashtruar si në vijim:
Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti Kontraktues) ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull: “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” dhe me numër të prokurimit: 616-25-2740-2-1-1.

2. Operatori ekonomik Black Tree LLC (në tekstin e mëtejshëm: Parashtruesi i kërkesës) pas publikimit të dosjes së tenderit ka vërejtur se një pjesë e kërkesave administrative dhe teknike, janë diskriminuese, në atë mënyrë që çrregullojnë konkurrencën e drejtë në mes të operatorëve ekonomik në industrinë e Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit (në tekstin e mëtejshëm: DDD). Duke marrë parasysh se Autoriteti Kontraktues mund të mos jetë mirë i njoftuar në lidhje me efektet negative të këtyre kërkesave në mesin e operatorëve ekonomik dhe me qëllim të rritjes së konkurrencës së drejtë dhe arritjes së vlerës për parandë, Parashtruesi i kërkesës paraqet këtë Kërkesë për rishqyrtim me të cilin kërkon eliminimin e kritereve diskriminuese si në vijim:

II. KËRKESA PËR STANDARDE ISO DHE EN TË PANEVOJSHME 3. Tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale autoriteti kontraktues ka kërkuar: “OE të jetë i certifikuar me ISO standard 9001 2015, 14001 2015, 45001 2018, & Standardin EN 16636 2015.” Duke marrë parasysh se në dosjen e tenderit por edhe legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë, industria e DDD është e rregulluar me legjislacion dhe standarde vendore, ku kërkohej licenca nga MBZHR, kjo e bënë të panevojshëm kërkesën për standarde të tjera evropiane apo ndërkombëtare, pasi që, kur standardet kosovare janë të aplikueshme, ato mbizotërojnë të gjitha standardet e tjera. Në Ligjin e Prokurimit Publik, neni 70 përcaktohet qartë rëndësia dhe renditja e standardeve që mund të kërkohej në aktivitetet e prokurimit në Kosovë: “Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t’u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare[...]”.4. Duke marrë parasysh se në rastin përkatës një licencë vendore është kërkuar në dosjen e tenderit, kërkesa për standarde të tjera është e panevojshme, pasi që vetëm se zvogëlon konkurrencën në mesin e operatorëve dhe nuk siguron asnjë vlerë të shtuar për autoritetin kontraktues. Siç dihet mirëfilli në Kosovë, përveç në rastet kur certifikimet vijnë së bashku me raporte përkatëse të auditimit dhe të akredituara nga shtetet anëtare të BE-së, certifikimet EN 16636:2015 është tejet e dyshimtë dhe pa asnjë vlerë në sigurim të cilësisë. Ato vetëm paraqesin një barrë financiare për operatorët dhe nuk sigurojnë kualitet për autoritetin kontraktues. Ne jemi të sigurtë që Autoriteti Kontraktues në këtë rast, nuk ka qëllim të uljes së konkurrencës dhe as dëmtimit të operatorëve më të vegjël, prandaj e sjellim këtë pengesë në vëmendjen tuaj, në mënyrë që të eliminohej kërkesat e panevojshme dhe të cilat mund të kenë efekt përjashtues për operatorët e rinj dhe me mundësi të kufizuara në blerjen e certifikimeve të tilla. Andaj kërkojmë që ky Certifikim të hiqet në tërësi.

III. KËRKESAT PËR STAFIN NUK JANË NË PËRPUTHJE ME VOLUMIN E PUNËS SË KËRKUAR 5. Tek pjesa e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Autoriteti kontraktues ka kërkuar: “OE duhet të prezantoj stafin profesional dhe teknik si në vijim: a) një Epidemilog me licencë valide pune së paku 3 vite eksperiencë në lëminë e DDD-së. b) Së paku 16 punëtor të punësuar me përvojë pune së paku tri vite në DDD. Nga stafi i lartëcekur në pikën b), OE duhet të ketë minimum 5 punëtor të certifikuar për IPM (Integrated Pest Management) për shërbimet e DDD-së”. 6. Fillimisht duhet theksuar se numri prej 16 punëtorëve duke marrë parasysh volumin e punës së përcaktuar në dosjen e tenderit, duke e ditur nivelin e automatizimit të shërbimeve të DDD është tejte i lartë dhe pengesë e panevojshme për operatorët më të vegjël. Parashtruesi i kërkesës konsideron se ky numër duhet të përgjysmohet për të qenë në linjë me volumin e shërbimeve që do të kontraktohen me këtë dosje të tenderit. 7. Në anën tjetër Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që: “OE duhet të ketë minimum 5 punëtor të certifikuar për IPM (Integrated Pest Management) për shërbimet e DDD-së”. Së pari duhet theksuar se Integrated Pest Management është metodologji/qasje e punës dhe nuk përbën standard certifikimi për njerëz apo produkte. Si e tillë kjo kërkesë nuk është e aplikueshme, pasi që IPM nuk përbën standard me të cilin Organizata e UN-it për Ushqim dhe Bujqësi (FOA) jep akreditim për certifikime. Çfarëdo institucioni i cili mund të ofroj këto trajnime, ato janë thjeshtë bartje e një përvojë të punës dhe nuk është edukim formal i cili mund të vihet si kusht i dosjes së tenderit, pasi që nuk ka organ akredituar për këtë lloj të trajnimit. IPM përderisa kërkohet si metodologji e punës është e pranueshme, por që punëtorët të jenë të certifikuar, kjo nuk mund të konsiderohet ndryshe përveç se si një kufizim i konkurrencës për operatorët të cilët kanë këtë certifikim nga ndonjë institucion joformal i edukimit. Në vend të kësaj kërkesë, Autoriteti Kontraktues duhet të aplikoj programe të akredituara në Kosovë dhe të cilat janë në përputhje me metodologjinë IPM dhe kërkesat rregullatorë Kosovare

IV. NË ANEKSIN 7 JANË KËRKUAR PAJISJE DHE MEKANIZËM SHUMË SPECIFIK QË FAVORIZOJNË OPERATORËT E MDHENJ -8. Autoriteti kontraktues në aneksin 7 ka përcaktuar një listë të pajisjeve dhe mekanizmit shumë specifik për kualifikim në këtë aktivitet të prokurimit, duke përfshirë:

PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM PËR PROJEKTIN ME TITULL: Dezinsektimi hapësinor i komunës së Prishtinës Nr. Lloji i mekanizmit dhe pajisjeve Sasia e kërkuar (cope) Numri identifikues i pajisjes:

1 Pompë motorike – gjenerator ULV (vëllim Ultra i Ulët/Ultra Low Volume) për dezinfektimin hapësinor të jashtëm 8

2 Pompa power-sprayer me gypa të gjatë së paku 50 metra me koka shtytëse për dezinfektimin hapësinor të jashtëm 2

3 Pompa motorike LV (Low Volume) të krahut për dezinfektimin hapësinor të jashtëm. 10

4 Automjete pune për vendosjen e pompave gjeneratorëve ULV dhe pompave power sprayer për kryerje të shërbimit të dezinfektimit hapësinor të jashtëm. (pick up ose kamionetë) 8

5 Automjete për bartjen e punëtorëve dhe pajisjeve tjera përcjellëse për kryerje të shërbimeve të dezinfektimit hapësinor të jashtëm. 4

9. Këto pajisje dhe numri i tyre janë shumë të detajuara dhe të panevojshme të përcaktohen në këtë formë. Secila kompani që ofron shërbimet e DDD, ka pajisjet dhe metodologjinë e pajisjet përkatëse për relizimin e punëve. Autoriteti Kontraktues, nuk duhet që të stër rregulloj pajisjet si kërkesa administrative dhe teknike, pasi që një gjë e tillë duhet të lihet në diskrecionin e operatorëve ekonomik, që të përzgjedhin pajisjet dhe mekanizmat për kryerjen e punëve. Për shembull, aty është kërkuar automjete në masën katër copë për bartjen e punëtorëve.

10. Kjo kërkesë është e panevojshme, pasi për autoritetin kontraktues është e parëndësishme punëtorët a do të barten me taxi, me autobus apo me një pajisje tjetër të operatorit. Diçka e tillë nuk i shërben arritjen së qëllimit të kontratës. Pra, operatorimundet që me aq pajisje sa i duhen për ditën përkatëse të organizoj punën, qoftë mepajisje të veta apo të nënkontraktuara dhe nuk ka nevojë që të rregullohet kjo kërkesë në dosjen e tenderit. E njëjta vlen edhe për Automjete pune për vendosjen e pompave gjeneratoreve ULV dhe pompave power sprayer për kryerje të shërbimit të dezinfektimit hapësiror të jashtëm dhe Pompa motorike LV (Low Volume) të krahut për dezinfektimin hapësiror të jashtëm. Prandaj nga ana e Autoritetit Kontraktues kërkojmë që nga operatorët të kërkoj të dëshmojnë se kanë pajisje të mjaftueshme për zbatimin e kësajkontrate, por jo ti përcaktojnë ato specifikisht, pasi që në këtë mënyrë dëmtohenoperatorët e vegjël dhe të rinjë.

11. Për të llogaritur sa pajisje ULV Generator nevojiten për të trajtuar 6,850 hektarë brenda 4–5 ditësh, përdorim të dhënat standard sipas specifikimit teknik të detyrueshëm

ANEKS 1: Të dhënat bazë:- Sipërfaqja për trajtim: 6,850 hektarë- Koha në dispozicion: 4 – 5 ditë pune, me 8 orë në ditë- Kapaciteti mesatar i një pajisjeje: 75 hektarë trajtim për një (1) orë= 600 hektar në ditë; 600 hektarë/ditë (75 hektar × 8 orë

Përmbledhje:Numri i Pajisjeve Sip. mbuluar/ditë - Ditë të nevojshme për 6,850 ha1 pajisje 600 ha – 8 orë pune ~11.4 ditë;2 pajisje 1,200 ha – 8 orë pune ~5.7 ditë;3 pajisje 1,800 ha – 8 orë pune ~3.8 ditë;4 pajisje 2,400 ha – 8 orë pune ~2.85 ditë;5 pajisje 3,000 ha – 8 orë pune ~2.3 ditë;6 pajisje 3,600 ha – 8 orë pune ~1.9 ditë7 pajisje 4,200 ha – 8 orë pune 1.63ditë; 8 pajisje 4,800 ha – 8 orë pune ~1.4 ditë Sipas përlllogaritjes së lartë cekuar del se 6850 hektar me përdorimin e 8 pajisjeve ULV Gjenerator, përfundon për (1.4) ditë një pik katër, e cila nuk është në harmoni me kërkesen e AK-së të vendos në specifikimin teknik të detyrueshme ku kërkohet që puna të përfundoj brenda 4-5 dite.Maksimumi 3 pajisje ULV Generator.Kjo llogaritje i përmbush kushte optimale të operimit (pa vonesa, me logjistikë efikase dhe rrugë të qasshme)12. Burimet njerëzore dhe teknike të nevojshme për realizimin e projektiEkipi teknik: 4 ekupe me nga 3 persona të trajnuar, të pajisur me pajisje mbrojtëse dhe mjete komunikimi -Mjetet :a. 3 automjete me pajisje ULV të montuara (grimca ?40µm) (Një ekip 1 ndar në 3 grupe me automjete të vendosura me pajisje ULV Generator)b. 2 pajisje portative ULV për zonat me akses të vështirë (Një ekip në grup)c. 1 pajisj ULV (Atomizer shpine) për trajtim në zona me bimësi të dendur (Një ekip në grup) d. 1 menaxher – epidemiplog për mbikqyrje dhe kombinim të preparateve.Sipas sqarimeve të lartë përmendura, nevojiten vetem 3 pajisje ULV GENERATOR, 2 pajisje portative ULV, 1 ULV (Atomizer shpine) dhe një epidemiolog si dhe 6 punëtor teknik.Kërkojmë që të hiqen, pajisjet dhe mekanizmat e nevojshme ku janë kërkuar 1: 8 copë, Pompë motorike – gjenerator ULV (vëllim Ultra i Ulët/Ultra Low Volume) për dezinfektimin hapësiror të jashtëm. Të ulët në 2 pajisje të tilla,Janë kërkuar: 2copa, Pompa power-sprayer me gypa të gjatë së paku 50 metra me koka shtytëse për dezinfektimin hapësiror të jashtëm, të hiqen në tërësi pasi që është pajisje e panevojshme për këtë projekt dhe e favorizon vetem operator të caktuar,Janë kërkuar: 10 copë, Pompa motorike LV (Low Volume) të krahut për

dezinfektimin hapësirave të jashtme. Të ulën në 3 copë, Janë kërkuar 10 copë Automjete pune për vendosjen e pompave gjeneratoreve ULV dhe pompave power sprayer për kryerje të shërbimit të dezinfektimit hapësirave të jashtme. (pick up ose kamionetë). Të ulën në 3 copë automjete pune. Janë kërkuar 4 copë, Automjete për bartjen e punëtorëve dhe pajisjeve tjera përcjellëse për kryerje të shërbimeve të dezinfektimit hapësirave të jashtme. Të ulën në 2 copë. Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1 Qëllimi, Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, Neni 27 - Dosja e Tenderit, Neni 28 - Specifikimet teknike, Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale, Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë. Andaj duke marrë në konsideratë të gjitha arsyet e cekura më lartë, i propozojmë Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës që të nxjerr këtë: V E N D I M te APROVOHET në tërësi si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim e operatorit Black Tree LLC me numër unik identifikues 812039271 dhe me adresë në rrugën Ulpiana, C9 13, Prishtinë. DETYROHET Drejtoria e Prokurimit e Komunës së Prishtinës që të bëjë eliminimin e kriterëve diskriminues siç janë sqaruar në këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 28.05.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0362/25, ndërsa me datë 10/06/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0362 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “BLACK TREE” L.L.C., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0362 ka vlerësuar si në vijim:

Duke u mbështetur në ekzaminimin e lëndës, konstatohet si në vijimë:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1. "OE “Black Tree LLC”.-Prishtinë, pretendon se A.K., Komuna Prishtinë nuk e ka respektuar qëllimin e nenit 1 të LPP-së. Ekspertja thekson se ndër tjera qëllim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese që të sigurojnë menyrë më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, si dhe të sigurojnë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publikë. AK e ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues si të pa bazuar, me arsyen se kriteret dhe specifikat e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, nuk janë në kundërshtim me dispozitat e theksuara më lart. OE pretendon se disa nga kriteret të parapara me NJK

dhe DT janë në kundërshtim me dispozitat e përmendura më lart. Ekspertja është e mendimit se nuk qëndron pretendimi i OE ankues sepse kriteret të vendosura janë të nevojshme me qëllimin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa arsyen më të detajuara do ta gjeni më poshtë. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2. "OE "Black Tree LLC"-Prishtinë, pretendon se A.K., Komuna Prishtinë nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 6 të LPP-së. Ekspertja sqaron se ndër të tjera qëllimi i nenit 6 të LPP-së është të udhëzohen autoritetet kontraktuese të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës. AK e ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues si të pa bazuar, me arsyen se kriteret e parapara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, nuk janë në kundërshtim me dispozitat e theksuara më lart. OE pretendon se disa nga kriteret e parapara me NJK dhe DT janë në kundërshtim me dispozitat e përmendura më lart. Ekspertja edhe për këtë dispozitë është e mendimit se kriteret të vendosura janë të nevojshme me qëllimin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa arsyen më të detajuara do ta gjeni më poshtë. Andaj, Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3. "OE "Black Tree LLC"-Prishtinë, pretendon se A.K., Komuna Prishtinë nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 7 të LPP-së. Ekspertja thekson se ndër të tjera qëllim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet të trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit. Pretendimi i OE ankues: se AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së. Ekspertja sqaron se sa i përket pretendimit të OE ankues, i njëjti pretendim është i pa bazuar, sepse AK ka lënë alternativa sikur për stafin profesional ku ka kërkuar si dëshmi kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshje për angazhim për këtë projekt edhe për pajisje ka lënë mundësinë e marrjes se të njëjtave me qera, ndërsa arsyen më të detajuara do ta gjeni më poshtë përkatësisht të pretendimit për shkeljen e neneve përkatëse që nderlidhen me pretendimet përkatëse. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4. "OE "Black Tree LLC"-Prishtinë, pretendon se A.K., Komuna Prishtinë nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 27 të LPP-së. Ekspertja sqaron se ndër të tjera qëllim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i shihet të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve. Ekspertja konsideron se në dosjen e tenderit janë dhënë sqarime të detajuara për mënyrën e këtij shërbimi dhe janë të plotësuara të gjitha detajet e përmendura më lart që nderlidhen me qëllimin e kësaj dispozite, ndërsa për kriteret kontestuese do ta gjeni sqarimin më të detajuar të nenit përkatës më poshtë që nderlidhen me pretendimin përkatës. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 5 dhe 9. "OE "Black Tree LLC"-Prishtinë, pretendon se A.K., Komuna Prishtinë nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 28 dhe nenin 70 të LPP-së. Ekspertja thekson se qëllim i nenit 28 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të

qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik, e që nenkupton se specifikat teknike janë kërkesa obligative për të gjithë tenderuesit. Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera. Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim. Nëse një standard i aplikueshëm, specifikim, ose miratim që kërkohet nga sipas paragrafit 4. nuk ekziston, ose nëse përdorimi i tij kërkon që autoriteti kontraktues të përdorë materiale ose produkte që nuk janë të përshtatshme me pajisjet që tashmë janë në dispozicion ose nëse përdorimi i tyre do të shkaktonte shpenzime të tepruara dhe të panevojshme, autoriteti i tillë kontraktues mund të përgatisë specifikacionin e tillë teknik duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës ose (ii) një miratimi teknik të Kosovës.

Ekspertja thekson se qellim i nenit 70 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktues se si duhet t'i përpilojë vendos kërkesa standard për sigurimin e cilësisë.

OE ankues nder te tjera pretendon se ;Tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale autoriteti kontraktues ka kërkuar: “OE të jetë i certifikuar me ISO standard 9001 2015, 14001 2015, 45001 2018, & Standardin EN 16636 2015.” Duke marrë parasysh se në dosjen e tenderit por edhe legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë, industria e DDD është e rregulluar me legjislacion dhe standard vendore, ku kërkohen licenca nga MBZHR, kjo e bënë të panevojshëm kërkesën për standarde të tjera evropiane apo ndërkombëtare, pasi që, kur standardet kosovare janë të aplikueshme, ato mbizotërojnë të gjitha standardet e tjera. Në Ligjin e Prokurimit Publik, neni 70 përcaktohet qartë rëndësia dhe renditja e standardeve që mund të kërkohet në aktivitetet e prokurimit në Kosovë: “Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t’u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare[...]”.

Duke marrë parasysh se në rastin përkatës një licencë vendore është kërkuar në dosjen e tenderit, kërkesa për standarde të tjera është e panevojshme, pasi që vetëm se zvogëlon konkurrencën në mesin e operatorëve dhe nuk siguron asnjë vlerë të shtuar për autoritetin kontraktues. Siç dihet mirëfilli në Kosovë, përveç në rastet kur certifikimet vijnë së bashku me raporte përkatëse të auditimit dhe të akredituara nga shtetet anëtare të BE-së, certifikimet EN 16636:2015 është tejet e dyshimtë dhe pa asnjë vlerë në sigurim të cilësisë.

Ekspertja sqaron se është e drejtë e AK të kërkojë standarde që sigurojnë cilësi në përputhje me llojin e aktivitetit të prokurimit varsisht nga ndjeshmeria e aktivitetit në fjalë, e sa i perket pretendimit te OE ankues se kur kerkohet një standard vendor nuk janë te nevoishme standard nderkombetare sepse vetem e ngarkojnë buxhetin dhe e rrisin shpenzimet siq ishte kerkuar licenca nga MBZHR, ku i njehta pretendon se kjo licencë është e mjaftueshme për aktivitetin në fjalë .

AK ka dhënë sqarime ne vendimin e dates 12.05.2025 me te cilin e ka refuzuar kerkesen per rishqyrtim se te njejtat standard pse janë te nevoishme dhe se te njejtat standard janë publike dhe te qaseshme per secilin operator ekonomik .

Ekspertja është e mendimit se aktiviteti i prokurimit ka ndjeshmeri te veqant dhe i njejt ndikon në shendetin e populates te vendit me më shumë banor si është ky aktivitet I prokurimit dhe kostoja e ketyre standardeve krahasuar me buxhetin e planifikuar dhe ndjeshmerisë-rendesisë se ketij aktiviteteti është e vogel andaj edhe si pretendim konsideroj se është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimin nr. 6 dhe 7. OE “Black Tree LLC”-Prishtinë, pretendon se A.K., Komuna Prishtinë nuk e ka respektuar qellimin e nenin 65 dhe nenin 66 të LPP-së .

Ekspertja thekson se qellim i nenit 65 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktues se si duhet t’i përpilojë kerkesat-krteret lidhur me pranuaeshmerin e kandidateve ose tenderuesve ,ndersa qellimi i nenit 66 të LPP-së është pershtatshmeria profesionale .Ekspertja sqaron se OE ankues nuk ka specifikuar konkretisht se qka nuk ishte ne harmoni me keto dispozita por vetem siperfaqsisht i ka permendur se janë shkelur nga autoriteti kontraktues .

Andaj Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 8. OE “Black Tree LLC”-Prishtinë, pretendon se A.K., Komuna Prishtinë nuk e ka respektuar qellimin e nenin 69 të LPP-së .

Ekspertja sqaron se ndër të tjera qellim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të përpiloj në dosje të tenderit krieret per nga aftesia teknie dhe profesionale .OE ankues pretendon se kerkesat per stafin nuk janë ne perputhje me volumin e punes, lidhue me kriterin :

Kerkesa :2. OE duhet të prezantoj stafin profesional dhe teknik si në vijim a) një Epidemilog me licensë valide pune së paku 3 vite eksperiencë në lëmine e DDD-së. b) Së paku 16 punëtor të punësuar me pervoje pune së paku tri vite ne DDD. Nga stafi i lartëcekur ne piken b), OE duhet të ketë minimum 5 punetore te certifikuar per IPM (Integrated Pest Mangement) për shërbimet e DDD-së.,

Deshmia:Lista e stafit profesional e nënshkruar dhe vulosur për stafin profesional dhe teknik si në vijim; Për piken a). Diploma-kopje, Licenca e punes-kopje, CV-a, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Për pikën b) kopje e certifikatave te IPM, CV-a, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Raportin mbi fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për tri vitet e fundit. Raporti nga ATK Pasqyra e mbajtjes në burim dhe pagimit të tatimit (VM).

AK kishte dhënë arsyetim per keto pretendime shihe arsyetimin :Ekspertja sqaron se e ka analizuar kriterin edhe vendimin i cili ishte nxierr lidhur me kerkesen per ri-shqyrtim ,dhe aty e ka vërejtur se nuk ka shkelje sa i perket stafit dhe numrit te puntoreve sespse,AK siq shihet në kriterin e vendosur është dhënë mundesia e marrveshjeve per angazhim e që nenkupton se edhe ofertuesit që kanë numer ma te vogel te punesuarve mundë te ofrojn marrveshje per angazhim ne kete projekt ,e qe shihet ne kriterin e paraparë me NJK dhe DT. Te cilin e vendosa ma lart.Andaj, Ekspertja Konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .OE ankues pretendon se :në aneksin 7 jane kerkuar pajisje dhe mekanizum shumë specifik që favorizojn operatoret e mdhenj lidhue me kriterin dhe aneksin 7 te DTShih aneksin 7 të DT:

PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHË(Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten dëshmit e kerkuara ne FTD)

Kerkesa :3. Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT

Dëshmia e kërkuar dokumentare:Lista e pajisjeve sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Dëshmi mbi pronësinë apo të marrjes me qira të mjeteve (obligative të dëshmohet edhe me foto të paisjeve dhe automjeteve). Cdo marrveshje mbi shfrytëzim duhet të jete e noterizuar për këtë projekt.

Ekspertja sqaron se e ka analizuar kriterin edhe vendimin i cili ishte nxierr lidhur me kerkesen per ri-shqyrtim ku ne menyre te detajuar janë dhenë arsye pse keto mjete janë te nevojshme per ketë aktivitet të prokurimit ,edhe për këtë kriter,pra për te gjitha keto mjete te punës me NJK dhe DT është sqaruar se mund të dorezohen si alternativë kontrata per marrje me qira te noterizuara te pajisjeve per ketë projekt ,pra ekspertja është apo ka mendim te njejt me AK se nuk qendron pretendimi i OE ankues e mbi te gjitha vendosja e kriterit me mundesi alternative siq u theksua ma lart per marrveshje per shfrytëzim per ketë projekt heq qdo dilem se kriteri nuk ka te bej me diskriminim apo favorizim.Andaj Ekspertja Konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkëlqeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin për kontratë të AK-së të aktivitetit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues – “KK PRISHTINË” lidhur me aktivitetin e prokurimit me “188 Dezinsektimi hapësinor i Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-2740-2-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - BLACK TREE L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: